

Takim bashkëpunimi i shoqatës "Pelioni,, me pushtetin vendor

Vera në Pogradecin e freskët

Ditën e shtunë, më 27 gusht 2011, në lokalin "Mokra,, në qytetin e Pogradecit u zhvillua takimi i përfaqësuesve të shoqatës "Pelioni, me kryetarët e rinj të komunave të Mokrës, të zgjedhur nga zgjedhjet e 8 maj 2011.

Nga shoqata "Pelioni" Tiranë,, përfaqësues ishin kryetari Pëllumb Zade, n/kryetari Isref Haxhillari, sekretari Zenun Fero dhe kryeredaktori i gazetës "Mokra" Flori Balliu (Slatina). Në takim ishte kryetari i degës shoqatës "Pelioni" për Pogradecin Llazi Tona, antari i kesaj dege Bujar Balliu, Koço Pihoni dhe "mokrari" Tomi Mato. Nga pushteti vendor ishin të pranishëm kryetari i komunes Propisht, z. Fuat Fero si dhe kryetari i komunës Velçan, z. Ilir Mani, ndërsa kryetari i komunes Trebinjë, për arsye objektive, nuk mori pjesë, por që ka shprehur gadishmërinë dhe përkushtimin për të gjitha pikat që u diskutuan si më poshtë.

Nenkryetari i shoqatës "Pelioni" Istref Haxhillari, hapi takimin dhe foli për rëndësinë e bashkëpunimit (faqe 2)



Nga Korça në Pogradec

Nga C.N.BURILEANI, 1905

JETA E NJERIUT ËSHTË SI LIQENI, HERË ME DALLGË E STUHI DHE HERË I QETË SI PASQYRË

Intervistë me regjisorin e mirënjohur, publicistin dhe intelektualin e shquar pogradecar, "Qytetar Nderi", 85-vjeçarin Tomi Mato



Mendime për librin e dy autorëve Istref Haxhillari e Bujar Balliu "Hapësirat rrallohen prej dhimbjes"

LIBRI I VEÇANTË I DY AUTORËVE

Nga Zenun FERRO

Në dasmën mirditore kërcen dhe vallet e Rrajçës

HOMAZH PËR RESMI RASIM HAXHILLARIN NGA DUNICA

DJALI I DUNICËS U LARGUA FIZIKISHT, POR JO NGA ZEMRAT TONA

HISTORIA NGA LASHTËSIA, MITOLOGJIA, SHKENCA E DIJA

Dragonjtë!

Nga Koço PIHONI

Cake Grofsh-tina më tha...

Tregim nga Bujar BALLIU

KOMUNIKIMI NËNTOKËSOR I BURIMEVE TË TUSHEMISHTIT DHE TË SHËN NAUMIT

Nga Jovan ZOTO

Takim bashkëpunimi i shoqatës "Pelioni," me pushtetin vendor

Ditën e shtunë, më 27 gusht 2011, në loka lin "Mokra," në qytetin e Pogradecit u zhvillua takimi i përfaqësuesëve të shoqatës "Pelioni, me kryetarët e rinj të komunave të Mokrës, të zgjedhur nga zgjedhjet e 8 maj 2011.

Nga shoqata "Pelioni" Tiranë, përfaqësues ishin kryetari Pëllumb Zade, n/kryetari Isref Haxhillari, sekretari Zenun Fero dhe kryeredaktori i gazetës "Mokra" Flori Balliu (Slatina). Në takim ishte kryetari i degës shoqatës "Pelioni" për Pogradecin Llazi Tona, antari i kesaj dege Bujar Balliu, Koço Pihoni dhe "mokrari" Tomi Mato. Nga pushteti vendor ishin të pranishëm kryetari i komunes Proptisht, z. Fuat Fero si dhe kryetari i komunës Velçan, z. Ilir Mani, ndërsa kryetari i komunes Trebinjë, për arsye objektive, nuk mori pjesë, por që ka shprehur gadishmërinë dhe përkushtimin për të gjitha pikat që u diskutuan si më poshtë.

Nenkryetari i shoqatës "Pelioni" Istref Haxhillari, hapi takimin dhe foli për rëndësinë e bashkëpunimit të shoqatës "Pelioni" me Pushtetin Vendor, dhe për nivelet e bashkëpunimit që duhet të rriten më tej, duke vënë theksin tek pengesat dhe vështirësitë që kemi hasur me pushtetin vendor para zgjedhjeve të 8 majit.

Ndërsa kryetari i shoqatës, z.Pëllumb Zade, theksoi se shoqata ka nevojë për një frymarrje më të gjërë dhe në forma të qëndrueshme, për një punë dhe seriozitet, për një bashkëpunim dhe një financim më të mirë dhe më të gjërë finciar lidhur me botimin e gazetës "Mokra" organ i shoqatës, zëri i saj që del çdo muaj, që nga marsi i vitit 1999. Z.Bujar Balliu vlerëson figurat e shquara të Mokrës, detyra është që ne t'i propogandojmë, t'i njohim e t'i nderojmë. Këtë pushteti vendor duhet ta ketë të specifikuar e detajuar në programin e punës vet.

Z.Zenun Fero theksoi se pushteti vendor është vendimtar në zonën e vet. Ky pushtet me punen e tij bën mrekullira, në interes të komunitetit, me plane dhe me programe të studiuara e planifikuara për çdo muaj, çdo vit, për kulturën, historinë, për gazetën "Mokra". Të gjitha këto vijnë gradualisht, por duhet përkushtim, vullnet, e bashkëpunim. Kryetari i komunes Velçan Ilir Mani shprehur gadishmërinë për një bashkëpunim më të gjërë me shoqatën "Pelioni" dhe me stafin e gazetës "Mokra", për një kulturë më të lartë në këtë Komunë. Ai theksoi se disa gjëra kemi bërë dhe të tjerat do t'i bëjmë në vazhdim, ju sillni propozimet, ju na mbështesni, ne

kemi nevojë për publikimet në gazetën "Mokra" të vendimeve dhe punes që bëhet në komunitetin e Mokrës nga pushteti vendor. Gazeta juaj e ka justifikuar veten si gazetë jo politike, po kulturore, historike e tje. Komuna e Velçanit, do të mbështesë të gjitha propozimet e shoqatës "Pelioni" në zgjerimin e saj, forcimin dhe botimin te gazeta "Mokra" do të sjellë në Komunë, aty banorët të gjejnë veten e tyre.

Kryetari i Komunës Proptisht, z.Fuat Fero, u shpreh se këto probleme që ne diskutojmë janë në të mirën e komunitetit civil në këtë Komunë. Bashkëpunimi me shoqatën, e veçanërisht me shoqatën "Pelioni" do të jetë i plotë i vazhdueshëm duke filluar nga viti 2012. Zgjerimi i shoqatës "Pelioni" do të bëhet edhe në komunë, me një strukturë të plotë organizative.

Kryetarët e komunave dëgjjuan më shumë. Një i mënçur ka lënë një fjalë: zoti i ka dhënë njeriut dy veshë dhe një gojë, që të dëgjojnë më shumë e të flasin më pak. Në të vërtetë të këta burra vlerësoj ertësia dhe fjala e matur.

Komuniteti civil ju u ka. Njerëzit të hapin dritaret e reja dhe të mësojnë se si t'i hapësh. Në Mokër të parët tanë kanë lënë një porosi të prerë: "Në të gjitha vdekjet të shkosh për ngushëllime, se njerëzit kanë

PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT I SHQATËS "PELIONI" ME PUSHTETIN VENDOR NË MOKËR

Në takimin e shoqatës "Pelioni" të datës 27 gusht 2011, u përgatit programi i bashkëpunimit si vijon:

1- Zgjerimi i mëtejshëm i Shoqatës "Pelioni" në komunat Proptisht, Velçan, Trebinjë e tjera.

2- Rritja e mëtejshme e bashkëpunimit të shoqatës "Pelioni" me pushtetin Vendor në Proptisht, Velçan, e Trebinjë, Rrajcë, Përrenjas, Udënisht e tjera.

3- Rritja e kapacitetit të botimit të gazetës "Mokra", dërgimi i saj mbi 50 copë në çdo komunë. Pushteti vendor të sigurojë transportimin nga Pogradeci dhe shpërndarjen e saj sipas kërkesave.

4- Gazeta "Mokra" do të financohet pjesërisht nga Pushteti vendor, nga fillimi i vitit 2012, me një kosto që miratohet nga çdo komunë.

5- Zgjerimi i festave në "Mokër, takime në çdo vit më 20 gusht në Velçan, do të quhet "TAKIMI I BREZAVE,, dhe do të organizohet sipas traditës mokrare.

6-Botimi në gazetën "Mokra" i vendimeve të Pushtetit vendor, aktivitete dhe puna e se cilës komune.

7- Të festohen përvjetoret e krijimit të shkollave në Mokër, në çdo fshat, e komunë, aty ku është e mundur.

8- Të organizohet një ekspozitë fotografike "Mokra në fotografi", si dhe mundësia e një dokumentari përmbledhës, në të ardhmen në Tiranë.

9- Vlerësimi i figurave të shquara në Mokër, propozime nga shoqata "Pelioni" për t'i nderuar nga Pushteti Vendor sipas legjislacionit në fuqi.

nevojë për njerëz, ndërsa në dasma bëj si të duash,, Në fillim të punës do t'u thonë: 'Kryetari,, ndërsa me kalimin e kohës të moshuarit nuk do t'u thonë kry-

etar, por gjithmonë "Djali i jonë". Kjo për ju do të jetë fitore. Puna juaj ka filluar, ju uroj suksese dhe bashkëpunim me shoqatën "Pelioni" dhe gazetën "Mokra".

Në dasmën mirditore kërcëhen vallet e Rrajcës

Nga mesi i muajt Korrik 2011 u shpërdanë ftesat e një dasme në një nga pallatet në Rrugën "Selman Riza" tek Bërryli në Tiranë. Ftuesi ishte Preng Reçi cili martonte djalin Rolandin në muajin Gusht.

Në ftesë ishte një shënim i çuditshëm pasi theksonte se jeni të ftuar në dasëm dhe dua të këndonit dhe të kërcënit vallet e "Rrajcës dhe të karhinës së Mokrës,,. E takojmë duke e falenderuar për ftesën, dhe i themi se neve ishim banorë të pallatit e mund të shkoni për vizitë e jo në dasëm, por ai me njëherë na tha: po e di se çfar do thoni! juve jeni ftuar mbi 15 çifte të cilat janë nga krahina të ndryshme, ky është qëllimi i ftesës jo ai që thua ti..... se bën dasmë për të ftuar... Unë dua t'ju respektoj të gjithëve, se më kanë respektuar e nderuar pavarësisht se nga janë, unë u jam mirënjohës që kur erdhem në këtë pallat në vitin 2007. Kryesorja është se nuk e di se a do të dali mirë apo jo, dua të kalojmë dhe të kënaqemi sa më shumë, unë ju kërkoi të kërcëni dhe të këndonit vallet e çdo zone por dua me çdo kusht vallet e Rrajcës dhe të Mokrës pasi të gjithë jemi nga zona të mesme dhe të jugut. Dhe ja kush janë: Kiçua e Roberti nga Kolonja, Ylli, Iliri, Andi, Erlandi, Erioni, nga Pogradeci e Mokra, Fadili e Pjetri nga Puka, Vali nga Dibra, Ramazani, Armeni e Behari nga tiranësit e vjeter, Adushi nga Vlora. Zabiti është miksi për të gjithë krahinat dhe veçanërisht nga krahina e Mokrës nga treva valleve të bukura të Rrajcës nga zona ku ne na lidhin e na bashkojnë shumë tradita e zakone të përbashkëta si respekti dhe mikëpritja, fjala e veshja, daullja, cigani e cyla, kërcimi e muha-



beti, jo pak rakia, dollia e tjera.

Ja erdhi data 14 gusht e djelë ora 9-12.00 ishte pritja tek lokali i Xhovalinit në hyrje të pallatit. Ishin vendosur lule dhe zbukurime të zakonshme. Prenga me bashkëshorten Gjelen ishin në lëvizje të vazhdueshme dhe në dilemë duke pritur e respektuar me përzemërsi vizitorët duke pritur urimet dhe falenderimet përkatëse, para fillimit të dasmës. Në një moment zbarkuan miqësia dhe të ftuarit, nga Mirdita, Durrësi e Tirana, po edhe ne të palateve pranë të cilët Prenga i kishte shumë merak. Kjo pasi ky mendonte se si do të ecte puna deri në fundin e ceremonisë. Kjo nuk di-hesh se kur do mbaronte. Dy djem të fisit mbanin shënimet për secilin dhe pyesnin se kush janë këta që vinë këtu? Prenga u thoshte ju mos i pyesni po shënoni emrin dhe ,,kujdes zarfin se këta janë të rëndësishëm,,. Shportat dhe tabakatë me pakot e qerasjes, gotat me raki lëviznin me shpejtësi nga duart e kamarierëve nga cepi në cep të lokalit. Dikush batutonte dhe bënte foto duke uruar të trashëgo-

het dhe u shtofshin më djem mirditorë. Të veçanta ishin urimet e xhaxhajt dhe të dajos së Rolandit me moshën e tyre, me respektin dhe me një urim shumë dashamirës, të cilët sado pak na njihnin, por u miqësua shumë shpejt duke bërë respektin dhe këmbyer urimet me përzemërta për pjesëmarrjen tonë në këtë ceremoni. Këta shikonin me shumë respekt të ftuarit e pa njohur në një dasmë mirditore.... Iliri e Genti prisnin dhe respektonin me shumë përzemërsi të gjithë të ardhurit për urim me buzeqeshje dhe falenderimet.

Ora shenonte 11.30 kur u dëgjuan borijet e makinave me zbukurime që po sillnin nusen nga Mirdita, nga Konaj-Fanë, një zonë me tradita e zakone të mrekullueshme, me mikpritjen burrërore e vlera te veçanta zakonore në periudhen e demokracisë. Ky moment solli emocione për cilindo dhe mes grumbullit të dasmorëve e të tjerë për rreth, Prenga, e Gjela presin me krah hapur çiftin, hidhen lule e raki, behen foto sipas traditës në vapën e 14 gushtit në hyrjen e pallatit. Çifti përshëndeste dhe me buqeshjen e thjeshtë Landi respektonte pjesëmarrësit ne ceremoninë e dasmës.

Lokali,restorant-JURGEN-DAJT ishte



përgatitur, e zbukuruar, dhe ishte gati për drekimin e 200 dasmorëve. Një koktej për një orë kaloi me urime, njohje dhe sisteminim në tavolinat e bukura e të mrekullueshme. Kishte edhe nga ata që nuk pranorin në tavolinën 17 se gjoja nuk mbanin përgjegjësi po të kalonin sasinë e pijes. Grupeve tona u ranë tavolinat 16,17,18, dhe ishin në ballin e sallës. Muzika që një zgjedhje shumë e bukur dhe e goditur nga Rolandi, për secilin pjesëmarrës. Per këtë duhet një respekt se ishte një dixheist dhe kur arrinte kulmi, valleve ky, edhe komandonte muziken edhe kërcente me ritmet e muzikës me pjesëmarrësit duke inicuar më tepër nxemjen e valltarëve te mrekullueshëm. Për të bërë respektin dhe plotësuar dëshirën që kishte Prenga kishte dhënë edhe një porosi se dikush do të sjellë disa valle të veçanta e për çdo kërkesë të tyre të kihet kujdes.

Gatimi ishte i veçantë dhe shumë i pëlqyer, pijet e mrekullueshme, dhe sherbimi shumë korrekt. Vallet nga grupet e zonave ishin në çdo rast që të kërkoi dhe me shumë bukuri. Nuk mbeti vallëzim pa kërcyer Ylli, Dushi, Mero, Bardha, Behari, Ladi, Zani, Andi, Iliri Erioni, Pjetri e deri Gjoka i cili me shumë respekt ngrinte duart dhe rrëkëllentë gotën e verës. Aty nuk kishte dallim se kush kërcen dhe nga jeni. Pra u arrit një organizim i përsosur duke u plotësuar të gjitha dëshirat e pjesëmarrësve.

Pas një qetësie momentale në një moment dixheisti ngriti fort zërin e autopalantit dhe u dëgjua një melodi daulle e cyle, pizge. Kjo ishte melodia e valles dyshe te thikave nga Rrajca, Gjithë salla u ngrit dhe panë me habi se çfar ka, po ja në mesin e saj ishin dy valltare amatore e dashamires Zabiti dhe Yllin me vallen dyshe të burrave. Këta kërcenin me rit-



Vera në Pogradecin e freskët

Pushuesit nuk janë larguar nga Pogradeci në këtë fundgushti. "Nuk është vetëm vapa e Tiranës, që i mban njerëzit këtu", thotë Kujtimi, një nga gazetashitësit, të cilin e gjen në baret e bregut të liqenit që në orët e para të mëngjesit. Kujtimi ka të drejtë. Në Pogradec pushuesit qëndrojnë edhe për shkak të mikpritjes që e dallon qytetin juglindor. Njerëzit janë të butë dhe kurrë nuk mungon përshëndetja sikur të ishim të njohur prej kohësh. Buzë liqenit, pushuesit të moshave të ndryshme kanë nisur shëtitjen e mëngjesit, ndërsa në lulishtet pranë bashkë me pirjen e kafes së parë të ditës dëgjohet edhe zhurma e ujtitëve të barit. Mes dy shëtitoreve shiriti i madh e i gjelbërt i mbushur me pemë ta shton ndjesinë e freskisë dhe të qetësisë që ka rrezatuar gjithmonë qyteti buzë ujit. Tashmë Pogradeci ka lënë pas dy problematika të mëdha, që i përkasin së kaluarës. Qyteti furnizohet 24 ore me ujë të pijshëm, ndërsa sistemi i kanalizimeve nuk ka asnjë lidhje me liqenin: ujrati e papastër përfundojnë në depuratorin e Zagorçanit, i ndërtuar në fushën ndën qafën e Plloçës.

met e melodies së daulleve, leviznin me shpejtësi, me ulje dhe me ngritje, me levizjet e duarëve dhe të ndjekur nga shumë interes nga pjesëmarrësit e të shoqëruar me duartrokite, tek këta nuk shiheshin veprimet dhe levizjet nga shpejtësia kur leviznin, uleshin dhe kalonin nga një cep tek tjetri i sallës. Kjo valle e melodi solli një emocion prekës dhe kënaqësi të veçantë të gjithë dasmorët të cilët e pritën duke shoqëruar me duartrokite, në vazhdim ishin vallet e bukura të Mokrës, të Strugës, "Lujma, lujma vallen O", e gjithë salla nuk pushonte së kërcyeri duke e mbyllur me vallen e bukur Rrajcare të kënduar nga Nertila Koka.

Aty kishte aq shumë dashamirës për vallet deri nga ata që kanë marrë pjesë në festivalet folklorike kombëtare, me grupet e valleve Rrajcare e kërkonin të mos mbaronte muzika e vallja.

Lodhja dhe vapa ishin jo te pakta, po nuk tregoheshin në pamje, aty më shumë ishtë kënaqësia e Prengës, e familjes e çiftit, e gjithë fisit ku na uronin, shoqëronin me duar lart dhe falenderonin për këto momente, supriza e bukuri që jepnin shoqëria e komshinjtë nga gjithë Shqipëria në një dasëm Miraitore. Me vallet e bukura nga Rrajca dhe Mokra u bë respekti ndaj njeri tjetrit për të treguar edhe respektin krahnor. Ky takim dasmor na la mbresa dhe një urim të veçantë për të gjithë se në raste të tilla u takofshim dhe çiftet të tjera martofshim me vallet e bukura Mirdito-Rrajce-Mokrare. Urime dhe faleminderit.

Zabit CUKU, Ylli XHELILI

"Nuk do t'i mbanim dot gjatë turistët pa i zgjidhur këto shqetësime", tregon Surjai, nga fshati Vërdovë, i cili zbret përditë në Pogradec për një biznes të vogël pranë liqenit.

"Këtë verë kemi patur më shumë pushues dhe të gjithë hotelet kanë qenë plot", vijon Surjai, duke treguar me kokë radhën e hoteleve që vazhdojnë deri në Tushemisht. Meço, një nga bashkëpronarët e hotel "EuroKorça", thotë se gjatë dimrit kanë kryer disa rikonstruksione në dhomat dhe mjediset e përbashkëta. "Kur pushuesit vijnë, duhet edhe t'iu përgjigjesh kërkesave të tyre", thotë Meço. Ndërkaq, buzë liqenit një grua e moshuar me përparse të bardhë ka nisur të pjekë lakrorë. Pushuesit janë kuriozë dhe qëndrojnë pranë banakut, bashkë me ata që kanë kryer porosinë. Më tej dikush shet "bukë pe qiqre", ndërsa në një banak të gjatë janë

vendosur punime prej balte apo prej leshi, që të gjitha të punuara nga disa gra të pasionuara.

"Pogradeci është qytet artistësh, bre", më thotë Kristaqi, një mësues letërsie në pension. "Pa shihni monumentet e Lasgushit dhe Mitrushit, tamam aty ku fillon shëtitorja". Rruga e destinuar vetëm për kalimtarët është shtruar me pllaka dyngjyreshe dhe në fund të sheshit një grup turistësh zbresin nga shkallët e pallatit të kulturës. Në katin e tretë është hapur ekspozita e Petra Cicit, i cili pasi ka përfunduar karrierën e gjatë të mjekut i është kthyer pasionit të vjetër, pikturës. Një vizatim i kujdesshëm, skrupoloz, që shpërfaq këndshëm liqenin dhe barkat shumëngjyreshe, rrugicat e pastra të qytetit, por edhe dëborën e bardhë që mbulon çatitë dhe që e bën më të freskët Pogradecin në këtë fundgushti të nxehtë. **ATSH**

HOMAZH PËR RESMI RASIM HAXHILLARIN NGA DUNICA DJALI I DUNICËSU LARGUA FIZIKISHT, POR JO NGA ZEMRAT TONA

Më 18 korrik 2011 u nda nga jeta, pas një sëmundje të rëndë e të pashërueshme, miku ynë i afërt, mokrari, dhe ish koloneli në rezervë Resmi Rasim Haxhillari në moshën 60 vjeçare, në qytetin e Elbasanit. Resmi Rasim Haxhillari, lindi në fshatin Dunicë, të rrethit Pogradec në nëntor 1951, në një familje me tradita mokrare. Arsimin fillor e shtatëvjeçar e kreu në fshatin e lindjes, me rezultate shume të mira, edhe me cilësi të larta si nxënës. Për këto cilësi të larta ai dërgohet në vitin 1965, në shkollën e mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej", në Tiranë, ku e mbaroi në vitin 1969 dhe pas kësaj vazhdoi Shkollën e Oficerave në Tiranë, në vitet 1969-1971, në specialitetin e këmbësorisë.

Akademine ushtarake e mbaroi në vitin 1980-të ku u karakterizua për cilësi të larta organizuese e komanduese. Për këtë ai spikati në repartet ushtarake në vitet 1972-1982, si Lushnje, Kukës, Elbasan, e tjerë. Ai respektoi të gjithë njerëzit ku shërbeu, me të gjitha normat e mirësjelljes dhe të korrektesisë.

Për aftësitë e tij, ai kreu detyra të ndryshme, nga komandant toge deri në atë të shefit të shtabit të divizionit në Kukës, e Elbasan, dhe në fund Komandant Brigade të Këmbësorisë në Elbasan. Kudo Resmiu, ishte një ushtark, një drejtues, por edhe një prind shëmbullor.

Familja e tij shëmbullore, rriti tre fëmijë, Gentin, Florianin e Erlandin, me cilësitë dhe virtutet më



të mira të familjes shqiptare. Bashkëshortja Barjamja, e ndoqi kudo ai shërbeu e punoi, duke u kujdesur deri në minutën e fundit për një bashkëshort shëmbullor si Resmiu.

Për Resmiun, kanë qënë të huaja ekstermizmat, e teperimet, ai është karakterizuar nga objektiviteti dhe morali njerëzor në punë, familje e kudo. Vetem pak muaj ai mbushte 60 vjeç, gjendja shëndetësore e tij, u keqësua dhe në betejën e tij të gjatë të sëmundjes fatkeqësisht, kësaj here ai doli i humbur. Lamtumirë Resmiut i lënë të gjithë: Cermonia, ndarja nga jeta u bë sipas rregullave ushtarake, nga komanda e garnizonit Elbasan. Në banesen e fundit përcillet me dhimbje të madhe.

Lamtumirë RESMI!

Nga: Syrja KASA, Beqir KOÇI, Hysni BAHITI, dhe ish kolegët ushtarakë Mokrarë, Zabit CUKU, Zenun FERRO, e Bashkim KRATA



Mendime për librin e dy autorëve Istref Haxhillari e Bujar Balliu "Hapësirat rrallohen prej dhimbjes"

LIBRI I VEÇANTË I DY AUTORËVE

Nga Zenun FERRO

Lexova librin e autorëve Istref Haxhillari e Bujar Balliu "Hapësirat rrallohen prej dhimbjes" botuar nga shtëpia botuese "ADA" në Tiranë, korrik 2011. Nga përmbajtja mu duk një libër i veçantë, dy autorët flasin me radhe, për disa probleme, sqarojnë shumë enigma gjatë krijimtarisë tyre, edhe kjo vazhdon për 84 faqe që ka libri.

Ky libër është një libër kritik i romanit "Pesha e Kohës,, i autorit Istref Haxhillarit dhe nxjerrin të dhënat e romanit të mëparshëm në diskutim. Në çdo pikë afrohen me njëri tjetrin mbi çështjet e romanit, dhe ky libër i bën një reklamë më të lartë atij, për të afruar lexuesin me romanin, me qëllim të vlerësohet vëpra, jo vetem nga autorët por edhe nga lexuesit.

Të dy antarët e njohin psikologjinë, historinë e rrethit të Pogradecit, duke e përsosur atë me sa më shumë të dhëna, vlera artistike. Lexuesi në këtë libër, me legjendet e Mokrës, me traditën, zakonet dhe bëhet pjesëtar. Kjo është një vepër letrare e rrallë në vendin tonë, dhe ca më shumë në Pogradec, që dy autorë bashkëbisedojnë dhe nxjerrin në pah, kulturën e kësaj treve.

Është si një terapi të lexosh faqet e këtij libri interesant, duket si një këshillë e çudi, por në ditët e sotme shumë terapistë këshillojnë pacientët e tyre të lexojnë një libër për të luftuar ankthin dhe depresionin.

Në prarathënie e librit "Loja e Fjalëve" poeti Dhimitër Pojanaku thekson se "herë pas here përgëzoj veten se ku e gjeti këtë mjeshër Haxhillari të mbajë në ankh lexuesin si një një teatër magjik". Kjo është një e vërtetë, edhe në këtë libër e mban në ankh lexuesin së bashku me Bujarin.

Në faqen 58 të librit ndizen dialogjet me legjenda të Pogradecit dhe të Mokrës, Legjenda e Debrovës, për fisin e lashtë Gjyly, që mbeten dy shtëpi, sepse kishte vrarë Sprijën dinake, e fuqishme që përllante lehtësisht cilindo, që afrohej në Mesguz. Gjaki-pirësja në fazën e fundit deshi të dintë emrin që e munda, se e mori vesh, mallkoi "Në sojin e Gjylit mos u varshin kurrë më shumë se dy armë,, faqe 60.

Në Trebinjë një fis mori emrin e Dragoit, këtë e tregon Bujar Balliu shumë qartë në këtë libër, se "gjarpërinjtë hyjnorë nuk janë kurrfarë tjetër, veçse dragojtë e mitologjisë popullore shqiptare, ndërsa enkelejtë të parët e fisit të Dragoit" faqe 62.

Legjenda e Hallmit të Homçanit, burri i legjendës, larguar shtatëmbdhjetë vite në emigrim, pa asnjë lajm për gruan, tre fëmijët, prindërit, dhe si u kthye për të qënë mes njerzëve të dashur.

Por ai takoi pleqërinë në hyrje të fshatit, që i kishte zënë një hall mbi hallet. Zogu i zi gjatë natës thërret "keq,, dhe fshati kishte nxjerrë çdo natë nga një burrë që ti kthejë përgjigje "mirë".

Kështu atë natë pleqëria vendosi emigrantin i cili u muar me këtë zog të zi "Keq-mirë, keq-mirë.....". Por nuk e përballoi dot nga malli që kishte për familjen e tij, dhe i ktheu përgjigje "Keq e më keq" dhe pas kësaj u shemb gjysma e malit e cila mori shëtipinë e familjen. E kobshme gjëma për kurbetliun. Nuk gjeti asnjë nga shtëpia e tij, nuk u çmall. Dhe shkalloi,, faqe 66

Legjenda e Ujit të zi, në Slabinjë, thanë që nëna nuk duronte dot të kalonte përfund oborreve e portave, ndërsa i biri ishte zhdukur nga ky ujë. Duroi shtatë apo dymbëdhjetë ditë dhe e bllokoi melesh të zi. Nënë doli fitimtare mbi lumen, faqe 67.

Legjendat vazhdojnë, pas këtyre lexojmë numurat që kanë bërë Nozi, një figure popullore në këtë zonë. E pati thirrur vjerra të zinte pikat e çatisë, pasi i rregulloi, i thotë vjerrës nga çatia, pa shiko a pikon?, Shiko, shiko-ia ktheu dhëndërrin-bëra ujët e hollë aty ku ishin pikat. Kur e morën vesh gratë e fshatit, qeshën më të madhe, faqe 75.

Por Nozi, e pësoi nga dy ushtarë, që i prisnin rrugën. Një pelë e tyre kishte lindur një mëz të vogël dhe nuk ecte me kalin. Për këtë, me armë e detyruan, Nozin që të mbante në kurriz. Gjatë rrugës Nozi thoshte me vete: "O zot, unë e thashë gabim, apo t'i nuk më kuptove, të kërkova kalë t'i hypja dhe jo të hipte.....faqe 76.

Numrat e Nozit janë të shumta, deri në fund, që ju do t'i lexoni. Mjekët i këshillojnë pacientët të lexojnë një libër dhe më pas të dsikutojnë përgjatë vizitës. Unë s'jam mjek, por në libër shihen më qartë emocionet, dhe librat janë një pafundësi, nuk skadojnë kurrë dhe vendosin vetë se sa kohë do ta lexosh dhe kur. Kush ka ndonjë ide të errët për jetën mund të ndjehet më i lehtësuar me autorët që dinë t'i përballojnë tragjeditë e jetës së përditëshme.

Sigurisht që librat nuk ndikojnë njëllot te të gjithë njerëzit. Megjithatë, ky libër ia vlen ta lexoni, të provoni, ndoshta edhe për të gjetur një shprehje ta paharrueshme. Është e këshillueshme ngë terapistët, që çdo person në libër duhet ta mbai gjithmonë me vete, sepse është ilaçi i shpirtit dhe mund ta rilexoni sa herë keni nevojë për t'u inkurajuar. Edhe ky libër ia vlen tam bash me vete, ta rilexoni sa herë keni nevojë për tu inkurajuar nga autorët Istref Haxhillari e Bujar Balliu, që aq bukur kanë bërë kritikën, autokritikën, legjendën popullore, dhe numrat, humoristikë të autorëve nga Pogradeci dhe Mokra.

Jeta e njeriut është si liqeni, herë me

Intervistë me regjisorin e mirnjohur, publicistin dhe intelektualin e shquar pogradecar, "Qytetar Nderi", 85 vjeçarin Tomi Mato

VEHBI FURXHI: Z. Mato, çdo njeri ka një fillesë jete, t'a fil lojmë t'a ngacmojmë kujtesën e ta ç'mbështjellim këtë lëmsh në kohë, nëpërmjet kësaj bisede.

Tomi Mato: Z. Vehbi, miku im i hershëm, bisedën tonë do t'a filloj me një këshillë të mençur, që na ka lënë babai i filozofisë botërore Ciceroni, i cili ka thënë: "Dëshmia që kallxon vetvehten është e një rëndësie të madhe, po e zhdue atë çdo gjë ka marrë fund". Kjo dëshirë më obligon të jem i ndershëm dhe i sinqertë në këtë bisedë. -Babai im lindi dhe u rrit në fshatin Alarup. Nevoja ekonomike e detyroi të emigrojë në Vllahi të Rumanisë dhe dy herë në Amerikë. Kurbeti iu bë një shkollë e madhe. Në mënyrë autodidakte mësoi shkrim e këndim dhe zanatin e muratorit. Kur u kthye nga emigracioni bleu shtëpi në Pogradec, filloi të punojë dhe u martua. Njëri pas tjetrit Zoti i dha pesë trashëgimtarë, dy çupa dhe tre djem, unë isha më i madhi. Mbasi mbarova shkollën fillore në moshën 12 vjeç fillova të punoj pas babait si saldator dhe punëtor. E shikon turizmin e vjetër, themelitet u hodhën në vitin 1939. Babai ishte sipërmarrës me gjithë Vangjelë e Petit. Shumë gurë, tulla e tjegulla kam zënë me duar bashkë me dy moshatarët e mi, Sotiraq Koven dhe Pandi Kërthin. Punoja 14 orë duke më vajtur djersët çurk tërë ditën. Pas punës në behar kridheshim në ujë e pastër të liqenit të Pogradecit. Babai dhe unë punonim vetëm në stinën e pranverës dhe të verës, në vjeshtë dhe në dimër babai nuk punonte. Nevojat familjare më detyronin të merresha me zejen e peshkatarit, bashkë me vëllezërit Taqo dhe Gaqo Sinjaku. Hidhnim rrjetat në orën 15:00 të ditës, bënim dru në pyll dhe ndiznim zjarrin në kasollen e Hudënishtit. Mbasi hanim bukë, flinim nja 3 orë, "shalonim" varkën dhe nga ora 22:00 nxirrim rrjetat. I qëronim ato nga peshku i zënë dhe pas mesit të natës i këputur nga lodhja shkoja në shtëpi për të fjetur. Të nesërmen shisnim peshkun e zënë dhe kur kish raste, që nuk na shitej, e hanim vetë në shtëpi. Zeja e peshkatarit, megjithëse kish vështirësi dhe e lodhshme më forcoi fizikisht, më kaliti dhe më burrëroi. Gjatë luftës së dytë botërore kam punuar lopataxi varke, 8 orë rrjesht Pogradec-Strugë. Pronarët e varkave Naum Shukja, Kopi Çalua, dhe Sotiraq Cici, më jepnin 300 lekë, vetë nxirrimin mijëra. Transportonim kripë, piperka, naftë dhe herbenj. I sillnim në Pogradec dhe i hipnim në makinë për në Korçë. Kemi sjellë mbi 30 hebranj, ata kishin me vete flori, këtë e pikasa kur paguanin pronarin e varkës. Lufta më la pa shkollë për 7 vjet. Mbasi çlirim të shkova vullnetar në tharjen e kënetës së Maliqit dhe më pas në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Elbasan. Në vitin 1946 u hap shkolla unike 2-vjeçare e natës. U regjistruan 86 të rinj e të reja. Semimaturën e morën 4 veta e të tjerët nuk e vazhduan. Nazar Berberi, Estat Oktrova, Qamiran Berberi dhe unë, Tomi Matua. Vullneti dhe këmbëngulja është mbreti i suksesit. Me Estatin vendosëm të shkonim në Dumvronjik, të Jugosllavisë, po më ndërroi mendjen Agron Minarrolli. Do të vish me mua për pilot në Beograd. Esati nuk deshte. Shkuam, na vunë në provë, n'a futën në një si kazan të madh, na vërtitën me një shpejtësi disa herë, rezistova dhe e fitova provimin. U prishën marrëdhëniet me Titon, nuk shkova dot pilot. S'di si do të kishte marrë rrugë jeta ime po të kisha dalë pilot, por mirë thotë populli: - "Bëmë me fat dhe hidhmë në plehut" dhe mua kështu më ndodhi. Më ndihua fati, se çdo e keqe ka dhe të mirën e saj. Në prill të



Në Pogradec, mes piktorëve të shquar Anastas Kostandini e Gjergji Lako

vitit 1948, vjen për të dhënë sfaqje në Pogradec, grupi artistik i Liceut "Jordan Misja", Tiranë, ku luajti në violinë Nikolla Zoraqi. Kishte 4 vjet që vinte për pushime në Pogradec në lagjen time, ishim bërë shokë. Kur ja tregova historinë e shkollës time, mbasi u mendua pak, duke më parë drejt e në sy e duke buzëqeshur më tha: -Tomi do të vish në liceun artistik, në degën e teatrit? Unë mbeta i hutuar dhe me gjysmë zëri i thashë: -Po unë s'kam luajtur kurrë teatër... S'ka gjë, pregatitu dhe do të vish në gusht, në Tiranë, për të konkuruar. U pregatita dhe shkoja bashkë me Esat Oktrovën fituam. Mbasi mbarimit të liceut artistik më doli bursa për regjizurë teatri në Akademinë e Arteve në PRAGË të Çekoslovakisë. Gëzimi ishte i papërshkrueshëm...

Z. Mato, Ju jeni 85 vjet dhe dukeni shumë vital në fizik, në gjendjen shëndetësore, shpirtërore, në aktivitetet kulturore-artistike, në publicistikë...Ku qëndron sekreti?

Përgjigje: Kam qenë dhe jam shumë i rregullt në jetë. S'kam abuzuar me alkolin, duhanin, me përjashtim të verës nëpër ahengje, dasma, ditëlindje e të tjera festa. Nuk kam pirë më shumë se 2 gota, aventurat me seksin femëror i kam urreyer. Në vitin 1950-'51 kam qenë drejtor i kampit të pionerëve, kisha rreth 20 edukatore, nuk i shkela normat shoqërore. Në liceun artistik ishte elita e bukurosheve të Tiranës, u përmbajta. Në Akademinë e Pragës kishte përveç djemve dhe shumë vajza, nuk shkela në dërrasë të kalbur... Në Pogradec para se të nisesha për studime në Pragë, ja dhashë fjalën dhe zemrën një vajze. TË DUA! Dhe ajo mu përgjigj plot dashuri dhe emocion: EDHE UNË TË DUA DHE DO TË PRES! Nuk e tradhëtova, mbarova akademinë dhe u martova me Najën. Jam burri më i lumtur i kësaj bote. Kemi 50 vjet martuar, të martuar të dashuruar...

Kemi ndarë detyrat e shtëpisë me mirkuptim të plotë. Pazarin e bëj unë, ndihmoj për pastrimin e bamjeve, mashurkave, spinaqit, qepëve e të tjera, kur gatuajmë tavë me peshk. Megjithëse

e ndihmoj gruan, ajo lodhet më shumë. Kemi rritur 2 fëmijë, jemi interesuar për të mësuar. Kurrë nuk jemi grindur, jetojmë në harmoni. Çuditë kur lexoj në gazeta, ose shikoj në television, që divorcohen çifte, grinden, goditen. Gjatë 50 vjetëve, as me trëndafil se kam goditur gruan time të dashur.

Sa herë shkoja për në punë, unë e puthja dhe e përshëndesja duke i thënë "Mirupafshim, lumturia e jetës sime". E kam konceptuar teorikisht dhe praktikisht martesën, gruan si të gatuar prej mjalti..., në qoftë se kam këtë shëndet, këtë gjendje të qetë shpirtërore e vitalitet, ja dedikoj sinqeritetit dhe mirëkuptimit me gruan. Fakt tjetër që më ka ndihmuar të kem gjendje shëndetërore dhe shpirtërore të mirë, është se gjatë kalvarit të jetës time në vite kam luftuar STRESIN, ANKTHIN, FRIKËN. Në fshatin e babait flitet se ka pasur CEMA, në mullirin e gjyshit, Vasilit. Tregohej se ka XHINDE. Në shtëpinë e murgës Nushkë, motrës së gjyshes, tregohej se natën të vrasin me gurë KANXHALLOZ-ËT. Në varret natën ngrihen të vdekurit, që kanë bërë gjynahe dhe bëhen LUGETËR... Këto përralla i ka trajtuar shkrimtari jonë i madh Mitrush Kuteli në rrëfenjën, "Lugetrit e fshatit tonë". Falë edukatës të babait dhe të nënës, të cilët që në vogëli më edukuan dhe më bindën të mos besoj, se ka lugetër, xhinde, kanxhalloze e ceme... vazhdimisht jam përpjekur ta dashuroj jetën, të kujdesem për shëndetin, për çdo organ të trupit, duke pasur parasysh gjithmonë këshillën e profesorit të filozofisë: "Tomash, Zoti të ka dhënë vetëm një herë JETËN. Kujto vazhdimisht se kur erdhe mysafir i kësaj jete ke qarë, të gjithë të tjerët rreth e rrotull teje kanë qeshur, puno në mënyrë të tillë, që kur të shtrihesh në shtratin e vdekjes, ti të qeshësh, e të tjerët rreth e rrotull teje të qajnë". Jam përpjekur të jem qytetar i ndershëm e shembullor. S'kam bërë asnjë mëkat, s'jam zënë me asnjë njeri, se kam shkëlur pragun e gjyqit, as e kam kapërcyer atë të burgut. Çdo mosmarrveshje jam

munduar ta zgjidh me mirkuptim. Jam frymëzuar gjithnjë nga një artikull që kam lexuar në gazetën italiane, "L'esspresso". Shkencëtari amerikan, Franklin Williams, që merrej me jetëgjatësinë e njeriut shkruante: "Doni ta mbani trurin të fresket, DUHET TA RUANI NGA STRESI". Nga eksperimentet që kam bërë në klinikë u binda se stresi, ankthi, frika i vrasin NEURONET e trurit, kufizojnë funksionet e tyre, sjellin sëmundjen e sklerozës. Këtë këshillë e kam ndeshur dhe në filozofinë e Panioit Iranian. Në mbështetje të kësaj ideje, studenti Persian Kerim Danaj më tregoi këtë fabul indiane. Një udhëtar takon vdekjen me kosë në dorë. E pyet: - "Ku shkon kaq me të shpejtë?" Ajo i përgjigjet: - "Të kosit 500 koka njerëzish". Mbasi disa orëve po ky udhëtar ndeshet sërish me vdekjen dhe e pyet - "Vdekje se mbajte fjalën, më the se do të kositje 500 koka njerëzish, në fakt kosite 5000. Vdekja iu përgjigj: - "Unë 500 kosita, të tjerët VDIQËN NGA FRIKA, kur më panë mua". (No nenga). -Shumë herë në klinikat e Pragës kam shtruar kuadro për ekzaminim dhe kurim të specializuar. Një herë kur ishte i sëmurë sekretari i Ambasadës Naumi, kardiologu që e kuronte më tha: Ti Mato, vuan nga ndonjë sëmundje? Jo, i thashë. Më ngacmoi. Po zemrën si e ke? Top i them unë, s'kam ndjerë asnjëherë ndonjë shqetësim, kam shëndetin e diellit. Doktorin vazhdoi të më zhbijojë. Do ta ruash këtë gjendje shëndetësore? Patjetër i thashë, dhe doktori çek më dha këtë këshillë: Në mëngjes si bën tualetin, pa ngrënë bukë bëj këtë veprim; përcill në gojë një lugë të vogël me mjaltë, pas 5 minutash pi një gotë të vogël me raki rushi safi, pa sheqer, mikrobet e etura turen tek mjalti. Ti i djeg me rakinë. Pa vonesë përtyt 3-5 thelpinj hudhra, që mos të mbajë erë të keqe goja fut pak djathë, osë përtyt majdanoz. Kam 55 vjet që e bëj këtë kurë, s'jam sëmurë, se kam shpuar trupin me gjilpërë dhe as kam pirë ndonjë tablet, s'jam shtruar asnjëherë në spital...

Sigurisht, je ushqyer mirë, me mish e Koran, ke pasur me bollëk...

Nuk kam vuajtur për të ngrënë, pas mishit nuk kam qenë tamaqar, sepse ato krijojnë intoksikacione, helmime në stomak. Ndryshe qëndron puna me peshkun, sidomos me koranin e belushkën. Mish i tyre ka fosfor që merr pjesë në formimin e neuroneve të trurit, por më shumë përdor supën prej shlunkave (circonkave). Mbasi peshkut, jam tifoz i bulmetrave, djathit, gjizës pa kripë, kosit se ka acid laktik që neutralizon në stomak intoksikacionet (helmimet), që krijojnë nga mish, buka e të tjera. Përdor me masë dhe gjalpin e dhisë, ujë s'ma pranon mideja, kafënë nuk e pi, gruoja s'më ka bërë asnjë kafe, ajo vetë pi dy në ditë. Shëtit shumë sidomos buzë liqenit më biçikletën, "Bianka".

Lokali juaj në qytetin piktoresk të Pogradecit quhet "PRAGA". Ç'lidhje ka ky emër me jetën tuaj, që ka qenë si LIQENI I POGRADECIT, HERË I QETË ME FAQEN PASQYRË, HERË PLOT DALLGË E TALLAZE TË MËDHA. Si i keni përballuar ato në kohë?

Jam shkolluar në Pragë të Çekoslovakisë. E konsideroj vehten si të privilegjuar të ZOTIT, që mora arsimin e lartë në Akademinë e Arteve të Bukura. Praga është një nga qytetet më të bukura të Europës, me kulturë tradicionale dhe bashkëkohore. Ka një popull inteligjent, punëtor, patriot, ka të zhvilluar artet, teatrin, muzikën, pikturën, skulpturën, arkitekturën, kështjellat, bazilikat e tempujve fetare, kishave dhe manastireve, e shumë mrekullira të tjera të realizuar nga mendja dhe Duart e popullit çek, të cilët



Mes shokëve (poshtë Hysen Hakani), student në Pragë

dallgë e stuhi dhe herë i qetë si pasqyrë

i kanë veshur këto monumente arti me rrymat e stileve gotike, rilindjes, klasicizmit, romantizmit e të tjera. Praga ka 22 ura që lidhin Pragën e vjetër me Pragën e re. I ndan lumi Vitava, me vepra magjike skulpture, kjo është Praga e artë. Kam vizituar disa kryeqytete në Europë si; Bukureshtin, Budapestin, Berlinin, Varshavën, Bratislavën, Beogradin. Të gjitha i harrova. Vetëm Praga mu skalit në kujtesë. Kjo ishte arsyeja që lokalit tim ia vura emrin "Praga". Ju jam mirënjohës prazhakëve, që më edukuan sjelljen e tyre europiane, ma injektuan dhe mua këtë kulturë qytetare. Ju jam borxh profesorëve, shefit të katedrës, regjizorit Antonjin Dvorzhakut, aktorëve të shquar Bohush Zahorskit, Otomar Krejces, të dy kanë ndëruar jetë. Ju vura buqeta me lule mbi gjoks. Libushe Peshkovës, Jozef Svobodes, e të tjerëve. Praga më dha mundësinë të njihemi me disa personalitete botërore të teatrit dhe kinematografisë si me; Zherar Filip, Marina Vladin, Gutner Karl Heger, Rudolf Jelineku, Bojan Stupica, me poetin e dramaturgun turk Nazim Hikmet e shumë e shumë të tjerë. Artistët çekoslovakë kishin respekt për popullin tim, për artin e dramaturgjinë shqiptare. Kjo ishte dhe një arsye më shumë që ia vura "Praga" emrin lokalit tim.

Në Pragë u vu në skenë drama e Kol Jakovës "Toka jonë", "Të rinjtë" e Vandush Vinçanit, "Në Gjenevë" e Selman Vaqarit përkthyer nga unë. Gjithashu mua mu dha mundësia të pregatisja për punë diplome, dramën e Kol Jakovës, "Halili dhe Hajria". Im bir Aurel Matua, u bashkua me mendimin tim për t'ia vënë emrin lokalit tonë "Praga", si shenjë respekti e mirënjohje për mua dhe dashurinë time për Pragën e Artë. U ktheva në atdhe me diplomë në xhep dhe e prita emërimin me shumë gëzim në Teatrin A.Z. Çajupi, në Korçë. Kisha respekt dhe dashuri për regjizorin e madh shqiptar dhe më gjerë Sokrat Mio dhe kolektivin e talentuar, por mbi gjithçka vlerësoja publikun e qytetëruar, artdashës dhe të kulturuar të Korçës. Ëndërroja dhe desha te prezantohesha me dramën "Takova Laska" "E TILLË DASHURI", të poetit dhe dramaturgut çek Pavel Kohout. E paraqita në kolegjiun, nuk ma pranuan me preteksin absurd "Ana Karenina" e Tolstoit hidhet në shinat e trenit, Lida Matesova e Pavel Kohout hidhet në shinat e tramvajit. Këtë dramë pas tre vjetëve e vuri në skenë Mihallaq Luarasi me shkollën e aktorëve në Tiranë. Paraqita tjetër, komedinë italiane që kishte marrë çmim të parë në konkursin e komedive të Aldo Benedetit, "Natën e mirë Patrice". Kolegjiun më thërret dhe do të më mbushë mendjen. Ka filluar polemika e shokut Enver me Palmiro Toliatin. Gabim politik. Nuk u dorëzova, paraqita dramën e vëllezërve Mrshqike "Marisha". Kolegjiun përgjigjet; Drama është analoge me tematikën e Operas të B. Smetanës "Nusja e shitur", që ka vënë TOBI. I inatosur, ju thashë që nuk kam tjetër, më jepni juve, kë të doni. Zv. Ministri Pipi Mitrojorgji, me gjithë drejtorët e arteve në ministri dhe mikun tim, Ismail Hoxhën më dhanë dramën e Minush Jeros "Dasmë në luftë". Vajta në Durrës, takova autorin, i tregova historinë, më pa me keqardhje. Kam disa vërejtje, ju lutem më mirkuptoni. Dramën time ministria ja u ka dhënë të gjitha trupave profesioniste. Se kanë pëlqyer, më tha Mitrush. Më dëgjo mua, mos u prezantoni me dramën time, merr një tjetër. Kam vendosur ta ve në skenë dramën tuaj. Ai më pa një cast në sy, e puthi dramën sikur do puthte një dashnore dhe në çast ndarjeje më tha duke më parë drejt e në sy: - Ta kam falur, ndryshimet bëji vetë. Drama pati shumë sukses. Mbas shumë dëshpërimeve fillova të ndiej nektarin e punës time si regjizor dhe respektin e



Në Pragë, mes artistëve të shquar Hysen Pelinku, Luçie Miloti, Mentor Xhemali, Lukë Kaçaj



Student në Pragë



Kopertina e librit të Tomit



Në Pragë, pas premierës së dramës "Halili dhe Hajria"

besimin e aktorëve dhe duartrokitjet e spektatorëve artdashës korçarë. Gjatë tre vjetëve që punova në Korçë vura me sukses gjashtë premiera, duke bashkëpunuar me profesorin Sokrat Mion.

Kur u festua 60 vjetori i Teatrit A.Z. Çajupi, në Korçë dhe 50 vjetori i Estradës profesioniste, nuk të pashë, pse kështu?!

Nuk më ftuan. Po të më ftonin do të thosha dhe unë disa konsiderata dhe kujtime të asaj kohe të vështirë. Kur bëhet dasëm edhe haroem njerëz pa ftuar, aq më tepër kur i zoti i dasmës është i ri. Kritizërve ju jepni nga një kafe. Ata le të të shajnë, ti shërbeji artit. Këtë këshillë i dashur miku im, Vehbi kam patur moto të jetës sime. Është më mirë të kesh merita e të mos i marrësh, sesa ti marrësh ato pa merituar.

Çfarë të veçante ka qyteti i Pogradecit, qyteti i Lasgushit, i Kutelit, por edhe tëndi?

Qyteti im është një "thesar" (Tomi tret shikimin e tij në hapësirë), jo vetëm për liqenin, për risitë e tij që përmban në vetvehte, që s'mund të gesh të dytë në botë, veçse siç thonë ndodhet dhe një tjetër në Bajkal, por megjithatë përsëri s'është si ky i yni. Vizitori, a turisti, qoftë shqiptar a i huaj, do të mbetet i befasur kur të shohë; - Varret monumentale të Selcës së Poshtme, Liqenet e Lukovës, Urën e Golikut, Gadishullin me Mozaikun e Linit ndërtoar në shekullin e pestë dhe të gjashtë të shekullit tonë, që paraardhësit tanë e kanë "qëndisur" si ndonjë qilim Persian me gurë të vegjël plot ngjyra ku pasqyrohen: zogj, peshq,

veriga rrushi...

-Mund të shohë fragmente të rrugës "Egnatia", kalanë që i ri si vetull kurorë qytetit, duke mos u ngopur sytë me pamjen fantastike të liqenit të Ohrit, të njohet me legjendën e "Harmonisë dhe Kadmit", që datojnë me shekullin e katërt para Krishtit. 4 km larg mund të ndjejë një kënaqësi shpirtërore në Volorekë - Tushemisht, të kredhura mes gjelbërimit të harlisur dhe ujit të pastër qelibar që të gurgullon poshtë këmbëve tënde, që vjen si rrymë ujore nëntokësore nga gryka ushqyese e Zaverit të Liqenit të Prespës. Rosat e mjellmat që notojnë qetësisht mbi ujë dhe nën të trofta lavrake.

-Hotelet, restorantet luksoze bashkëkohore si "Delfini" e të tjerë, por dhe shtëpi karakteristike të turizmit familjar, të ofrojnë mirseardhjen, mikpritjen, gatimin tradicional me një guzhinë special, e verën e mrekullueshme prej buti, një shërbim të kulturuar që të bën të rikthehesh përsëri.

Bleta nuk rri pa prodhuar mjalte. "Pena" jote ç'ka shkruar këtë kohë?

(Tomi ve buzën në gaz, mbasi mendohet pak më tregon për krijimtarinë e tij botuese) -Kam botuar dramën: -"Lulishte për gjyshrit", Monografinë: -Kushuar artistit virtuoz në klarinetë dhe Saks Jashar Nazif: - "Lavdi dhe tragjedia e një muzikanti". Me rastin e 100 vjetorit të madhorit pogradecar Lasgush Poradecit botova librin: "Të vërteta e të pathëna për Lagushin" (është ribotuar katër herë). E përfundova librin tjetër kushtuar meteorit pogradecar Mitrush Kutelit (Dhimitër Paskos) - "Pa dëgjoni Mitrushin ç'thotë..." Po përgatit librin Kujtime: "Pragë të mora me vehte". Derisa të më rëgëtojnë gjakun në damar, dhe të më punojë mendja do vazhdoj të shkruaj. Të shkruarit më jep vlagë shpirtërore, më frymëzon, më rigjeneron shëndetin. Pastaj vazhdon! Prej vitesh këtu në Pogradec, në verë vjen shkrimtari jonë i madh, Dritëro Agolli, një "monument i gjallë", që duket sikur do t'u thotë nëpërmjet monumenteve të poetit të madh lirik Lasgushit, e tregimtarit të mrekullueshëm Mitrush Kuteli, të vendosur mes gjelbërimit e trëndafilave shumëngjyrësh, në lulishten në breg të liqenit. "Ja erdha miqtë e mi, t'ju shoh përsëri, më kish marrë mall..." dhe puhiza që vjen nga liqeni i kaltër, përkëdhel flokët e gjata ngjyrë ergjendi të Dritëroit dhe monumentet duket sikur flasin me të...

- (Tomi, duket sikur e përjeton shpirtërisht këtë takim, me sytë e njomur dhe sikur ai është personi i katër në këtë bisedë...)

-Tomi pasi rri pak në heshtje, sikur përmendet si me qenë në një ëndërr, më shikon mua dhe pastaj hedh shikimin në faqen e qetë të liqenit, e gjysmën e zjarrit të diellit, që si një kalorës ecën për të kapërcyer malin e për të mos u dukur më deri në mëngjesin e ditës tjetër, e ja lenë vendin hënës të verdhë mjalte si kosore, që duket, që vjen e ndrojtur, si ndonjë vajzë e re e brishtë në takimin e parë, duke ecur në qiellin e kaltër në gri, e duke sjellë me vehte atë mbrëmje verore të papërsërishme shumë të bukura e ledhatuese, qetsuese, frymëzuese e rigjeneruese të shpirtit e trupit të lodhur të njeriut nga stresi...

-Duke mos dashur ta lodhim Tomin, këtë "thesar" jetësor, plot dije, punë të frytshme në vite, një simbol, jo vetëm për Pogradecin, që sa herë ta takosh, e të shkundë kujtesën, nxjerr "mjell të bardhë", jo vetëm për një shkrim e një libër, por për dhjetra të tjerë. Duke i uruar shëndet, jetë të gjatë aktive, ndahem nga miku im i mirë dhe i veçantë Tomi Mato në këtë mbrëmje të bukur gushti në Pogradec.

Intervistoi: Vehbi FURXHI (Marrë nga gazeta "Korça")

Mbyllet edicioni i parë i Festivalit të Filmit Ballkanik dhe Kulinarisë në Pogradec

“Aromë nga Kostandinopoja”, filmi më i mirë i festivalit

Filmi i shkurtër “Si qeni n’rrush” në regji të Driton Hajredinit dhe Yll Çitakut është shpërblyer me çmimin për filmin më të mirë të shkurtër në edicionin e parë të Festivalit të Filmit Ballkanik dhe Kulinarisë, që u mbajt në qytetin e Pogradecit. Ndërkaq, filmi më i mirë i festivalit u zgjodh filmi grek “Aromë nga Kostandinopoja” i regjisorit Tasos Boulmetis.

Më 4 shtator është mbyllur edicioni i parë i Festivalit të Filmit Ballkanik dhe i Kulinarisë, i cili u mbajt në qytetin e Pogradecit, për një javë rresht. Në mesin e filmave të regjisorëve ballkanikë, ky festival mundësoi njohjen edhe të traditës së gatimit. Ceremonia e ndarjes së çmimeve, jo si zakonisht, këtë herë nderoi pjesëmarrësit me një pjatë të punuar në mënyrë artizanale, që bartte edhe çmimin e mirënjohjes për të gjithë pjesëmarrësit. Ceremonia u zhvillua në kinemanë e qytetit. Filmi më i mirë i Festivalit u zgjodh filmi grek “Aromë nga Kostandinopoja” i regjisorit Tasos Boulmetis,

Çmimi i Jurisë i shkoi filmit kroat “Një natë e bukur në Split” me regji të Arsen Ostojiç, Çmimi Special shkoi për filmin me metrazh të shkurtër “Trenat” (Pavel Vesnakov), dokumentari më i mirë u vlerësua realizimi serb “Kinema komuniste” i regjisorit Mila Turajlić, Filmi më i Mirë i Shkurtër u vlerësua “Si qeni n’rrush” me skenar të Driton Hajredinit dhe regji të Driton Hajredinit dhe Yll Çitakut. Filmi “Si qeni në rrush” i regjisorit Hajredini, i cili kohët e fundit ka vjelë disa çmime, trajton temën mbi luftën, përballjen me vdekjen dhe zgjedhjet që duhet të bëhen. Kjo temë vjen me lojën e një treshe aktorësh, të



cilët jemi mësuar t'i shohim ndryshe.

Komikët “Stupcat” vijnë në një format tjetër, duke pasqyruar herë komikën e herë tragjiken, nëpërmjet tre piktorëve që vihen në një situatë ku njëri prej tyre duhet të vdes. I vendosur gjatë luftës së fundit në Kosovë, filmi trajton brutalitetin e luftës, me tone absurdate por edhe humorit. Tre piktorët vendosin të shkojnë në fshat për të bërë aheng dhe rrugës ndalohen nga një postbllok i policisë serbe. Njëri nga ta duhet të vdes, por në përballje me vdekjen, dëshira për të jetuar është më e madhe se kurrë, dhe

atë që nuk mund ta bëjnë vet, ia lënë shortit për të zgjedhur.

Festivali i Pogradecit ndau edhe çmime dhe mirënjohje tjera për bashkëpunëtorët, ndërkohë që edhe çmimi i Kulinarisë nuk mbeti pa zot. Këtë edicioni i takoi qytetit të Pogradecit. Të gjithë pjesëmarrësit, patën mundësi të shijojnë ushqimin tradicional të vendeve pjesëmarrëse në festival. Njëri nga ideatorët e këtij festivali, regjisorin Eno Milkani, tha se ky edicion i parë i festivalit ia arriti qëllimit. “Ky edicion ia arriti qëllimit: të bëjë bashkë disa artistë nga Ballkani, të prezantojë kinemanë e këtij vendi dhe të na japë mundësi të kalojmë kohë e të njohim njëri-tjetrin”, theksoi regjisorin Milkani.

Në festival u prezantuan filma me metrazh të gjatë dhe me metrazh të shkurtër nga Kroacia, Bosnja, Mali i Zi, Greqia, Serbia, Bullgaria, Shqipëria, Kosova etj. Secili shtet pjesëmarrës ka sjellë filma dhe dokumentarë që trajtonin problemet e Ballkanit, dhe konfliktet e tij ndër shekuj.

Cake Grofshtina më tha...



Tregim nga Bujar BALLIU

Të kam vëlla. Më ler këtu! Do më çosh te Sabua? M'u neverit. Vendosa të mos kthehem. Jam rehat. Punoj për të ngrënë. E veshura? Ja siç më sheh. Lahem vetëm kur shkoj me kurva. Më morën ca çuna. U duhesh. Rrugës ndërruan mendje, thanë t'i prisnjia këtu. Ia futa me të pirë. Ç'më shikon ashtu? Kujton se merrem me punë të pista? Nuk e ke njohur Caken edhe pse kemi lojtur aq shumë në Ndërgurës, sa i gjen dhe sot plloçat e lëvizura pe vendit. Në shpirt jam i pastër. Pislleqet i kam përsipër. Pa to o do çmendesha, o do vrisnjia veten. E vras si thua ti? Nuk besoj. Vetem e vret kush nuk përballon vuajtjen. Jam tjetër soj. Më funksionojnë damarët e moskokëçarjes. Hë mirë e kam? Edhe nuk çmendem. Fatkeqësisht dalloj qartë bu dallallëkun tim. Ndiheh mirë me të.

Dëgjo! Ose zbritmë nga makina e më ler aty ku më kish zënë gjumi, ose duro të shfryhem.

Kam qenë fëmijë i zgjuar, hë? Çudi! Me ato kushte në shtëpi, merrnjia nota të mira. Nuk zihesh kurrë. Kokështrëm-bri më ra më qafë.

“-Trim i biri i Sabos.

-Ke inat, ti? – iu trimërova.

-Po të jesh i zoti merr hak për tët ëmë.

-Nëna vdiq pe zotit, -përsërita fjalët e gjyshes.

-Posi! E vrau Sabua me plakën.”

Mbeta pa frymë.

Në shtëpi, për herë të parë vështrova imtësisht tim atë. I pësthirë. Mjekra shndriste nga stërkalat e jargëve që rridhnin hollë nga cepi i majtë i gojës së sh-

trembër. Mbi buzën e sipërme vareshin qime të rralla. Nga fytyra e gjerë vështronin dy sy të veckël, të zbehtë, çakërr, sikur kërkonin njëri-tjetrin ngaqë ishin vendosur tepër larg.

Gjyshja topt hleqash. Cepi i çitjanëve ngrinte re pluhuri ku përzihej dhe u dyshemesë me hirin e vatrës.

E ndienja veten breshkë e plandosur në kurriz. Qafën, këmbët, zhguallin e rrobave i përshkonte frika. Më parë shihja vetëm poshtë. Tani, me sytë nën tim atë, jetonja pamundësinë për t'u kthyer me këmbë në tokë.

Si ia morën frymën? Nuk u erdhi keq, më lanë jetim.

-Kush ma vrau nënën, ti apo ti?

Përgjigja erdhi flakërimë. Në faqen e nxehur ranë stërkala jargësh. Doja me tërë fuqinë e shpirtit të mos nxirrja zë e lot. Ngrita sytë lart dhe i qëndrova vështrimit të tij. U përpoqa të zbulonja thellësyve të vegjël në u drodhën nga inati apo u bënë pishman për dhimbjen që më shkaktuan. Përballë fytyrë e zbrazur guhaku.

Gjyshja nxinte nga koka te këmbët.

Përplasa derën. Dola. Errësira shtruar këmbëkryq nën strehë, në oborr, mbi arë, sidomos rrezës së pemëve. Dëgjohej vetëm gurgullima e përroit. Fshehur te qymezi i pulave, më trullosi kundërmimi i jargëve të Sabos dhe glasave.

U zgjova nga hungërima e menteshave të derës. Pas drurit më kërkonin. Edhe pse mbushur me inat, diç iu zbut kryneqësisë. Nuk po më linin vetë. Sabua nxitoi drejt arës së madhe. Nën këmbë i kërcisnin si eshtra gjethet e thara. Te trunгу lëvizi një hije. Pas pëshpërimave, u shkujdesën, ngritën zërin.

-Kemi të reja?

-Po shef. Kryetar i koprativës vjedh.

-Mos e kruaj kurrizin kot. Ç'detyrë të kam ngarkuar?

-E di, e di, agronomin. Flet ai, shef, flet. Dje i shkova afër kur llafoheshe me Dulen. Bënja sikur hiqja bëzhidila pe kanalit. “Kërqe, i tha- ke marrë? Të duhet. Zbardhi trarët e tymosur.

-Jo or agronomin, e kam gjizë, - u përgjigj pa shejtanllëk i ziu njeri.

-Ehë, e paske kërqe për të zbardhur, zorrën.”

-Kështu tha më plaçin sytë. Si ore e qojti kërqe bulmetin e koprativës?

-Ule zërin...

Pëshpëritën nuk e di sa kohë. Më doli gjumi ndaj të gdhirë me kokën në gurin ku pijnë pulat ujë. E kisha dëgjuar tim atë të dilte natën, po mendonja se shurosej. Pas bisedës më dukej i frikshëm. Shyqyr që nuk më kërkoi.

Vrapova tatëpjetët, iu qepa një makine. Sa qef bënim kur u vareshim nga Udh' e madhe gjer te varrest e Çelës. Po këtë radhë do t'ia mbathja, ndaj u rojta mos më pikaste shoferi. Fshehur në pjesën e përparme të karrocërës, ngarkuar me trupa bredhi, përfundova në Pradec.

Të kujtohet kur më kthyen? Lëvdosha, pashë ndeshje të vërtetë futbollit, xhama dyqanesh sa dy bojë njeriu, acfalt. Atëherë ia vara shkollës. Jam biri i Sabos unë.

Pas ushtrie, punova si kalë. Iknja nga shtëpia më të gdhirë e kthesha më terrtit. Mësova të vërtetën për nënën. Ma treguan komshinjët. Ti e di, po kam qef ta them. Ja ç'ka mbirë nga fara e Cakes, atij Cakes së parë me goxha nam në kohë të tij.

I sapolindur qanja shumë. Sabua hidhej pas atyre që ngrinin koprativën. Nëna u lig u tret. S' kishte as me se të më ushente as me se të ushqehej. Plaka e rrihte.

-Shko lyp, -thoshte.- Ç'më ka gjetur mua? Kështu e rrita tët shoq. Tani s'më japin më. Dil me fëminë për gjiri t'u vijë keq.

-Pse s'merakoset i ati? Harroi ç'ka lënë shtëpi? Këtu do ngordh me gjithë këtë e nuk e shtri dorën gjëkund.

E çuknavitën. Nga të goditurat në kokë iu hap një plagë. I rridhte ditë e natë. Iu infektua. Vdiq pas pak ditësh. Jetime, njeri pa njeri. E si ta dua Sabon?

Atë behar mora një dorë të mirë parash. Qe viti kur arrestuan agronomin. E more vesh tani që shkaktar u bë Sabua me spiunllëqet e tij?

Shkreha në Pradec. Ngryssha e gdhisha tapë. Rrija me Markon, “debilin”. Më njohu me Betën. Ç'fëmë! Mësova tërë ato lezete. Më shtyrdhi. S'ndasha dot. E mora në shtëpi, të harronja Sabon.

Kur u ktheva, plakën s'e gjeta. Leekat ia kishin mbledhur kapiçë në një qoshe.

Betës i bëri përshtypja shtëpia. Dy dhoma si karakoll njëra mbi tjetrën, lidhur nga jashtë me shkallë guri. E kish ndërtuar Cakja i parë, kryeplak në kohë të Turqisë. Gjysmën e shembi Sabua, i

vuri kazmën kur hyri Partia. I mbushën mendjen për flori të fshehur e ai do t'ia dorëzonte pushtetit të ri.

-Kaq të varfër jini?

-Pse ka të pasur atdheu ynë? - u talla kot. Beta nuk e vriste mendjen në ç'sistem jetonim.

Sabua erdhi para se të ngrysej. I rrojtur, i qethur, i krehur. Xhaketa ngjyë kafe i jepte nur. Jargët në rrudhën anës mjekrës mezi dalloheshin. E shikova drejt. M'u përvodh. I zgjati dorën Betës.

-Miserdhe.

Ajo e përqafoi.

-Tashi do ndryshojë shtëpia. Do mbajë erë grua.

Më erdhi mirë. Të paktën nga jashtë të mos i dallohej fëlliqësira.

Atë natë u llafosem gjatë. Ajo thosh “m'u mërzi qyteti, fshati ka qetësi. Unë ia ktheja se këtu të hanë mizat e bajgat, të ikim.”

M'u hodhët për gryke, sidomos ti, kur Beta iku.

-Kurvë,- të thashë. E vërteta kishte më shumë.

Tre ditë premë në Qyrfaq lëndë për koprativën. Flinim atje. U kthyem në mesnatë të lodhur e të dërmuar. Njëpër shkallë ndjeva kollën e Sabos. Qëndrova. Vinte nga kati i parë apo i dytë? Hapa me vrull derën mbyllur nga brenda me mëndallë druri. Sabua dhe Beta u ngritën gjysmë lakuriq.

-Gjer këtu arrite?

-Ajo për atë punë ka ardhur.

Veshi pantallonat. Doli pa më hedhur sytë. S'pata fuqi as të ngrej dorën. Pas tij vrapoi Beta. S'e pashë më.

Të tjerat i di.

Do më pyesësh pse nuk u martova. Në Greqi m'u bë sepse një sëmundje rrugësh. Më la steril.

Nga Grofshtinat kam mbetur unë e Sabua. Zajet me emrin e fisit i rrëmbeu lumi. S'do mbetet nishan pe nesh. Më mirë kështu?

Hë, ku do më lënë? Në shtëpi të vras Sabon? Jeta e shthurur më çliron nga e shkuara.

Kam tetëmbëdhjetë vjet pa e parë. Kushedi sa është shëmtuar. Pleqëria të ndyrët i ndyn edhe më.

Te ty nuk vij. Jam këllirë.

Mbaje makinën.

Hajt, natën e mirë.

Historia nga lashtësia, Mitologjia, Shkenca e Dija !

Dragonjtë!

Nga Koç PIHONI

Është paksa e çuditshme, në kufijtë e së besueshmes e të pa besueshmes, fantazisë dhe së vërtetës kjo histori sa enigmatike dhe emblematike për shumë popuj në botë. Duke u ndalur fillimisht në qytetin e Pogradecit sot, vëndbanimi i hershëm i fisit Ilir të Enkelejve. Pak Mitologji nga lashtësia:

Shkenca sot ka bërë të mundur të hedhë dritë mbi shumë gjëra nga periudha të hershme nga lashtësia, qysh nga formimi e lindja e jetës në Tokë, sipas teorisë të Oparinit, për të gjitha këto do të përmendja e marr si pikë referimi edhe Sistematikën e Specieve e Llojeve të Bimëve, sipas Karl Lineut e Teorinë e Evolucionit të Botës së kafshëve e Ligjin Universal të Përshtatshmërisë me kushtet e ndryshimit e diktuar, të cilave Çarls Darvini i kushtoi gjithë jetën, si dhe tabelën e Elementeve Kimikë të Mendelejevit e shumë zhvillime të më vonëshme të shkencës. Këto bënë të mundur shpjegimin e shumë fenomeneve të pashpjegueshme deri atëherë. Nuk do doja të le pa përmendur dietarin, palentologun Didëro, i cili rolin e evolucionit në botën e bimëve dhe kafshëve në kahje të kundërta që sigurojnë *progres a regres*, e komenton kështu: "Një krijesë e madhe mundet të përfundojë në një krijesë të vogël, sikurse një krijesë e vogël në një gënie të madhe të ndërlikuar."

HISTORIKU I LINDJES E EVOLUCIONIT TË DRAGOIT

Miliona vjet më parë në planetin tonë, në Tokë, ekzistonin kafshë parahistorike, një florë e faunë krejt e ndryshme nga kjo që kemi sot. Ku përfaqësuesit më të mëdhenj kanë qenë dinosaurët, një familje e madhe hardhucash gjigande e zvaranikë reptilë të pakrahasuara me këto që njohim ne sot. Këtu bëhet fjalë para 60-65 milionë vjet më parë, përpara se në Tokë të ndodhte një ndryshim i madh klimaterik. Ky ndryshim shpjegohet si rezultat i shpëputjes së një Meteori X, i cili solli ndryshime të mëdha në ngrohjen e klimës, e cila bëri të domosdoshëm ngritjen e temperaturave në Tokë dhe rritjen e nivelit të ujërave. Kjo gjë bëri që

një pjesë e madhe e këtyre specieve të zhdukeshin dhe një pjesë prej tyre t'u përshtateshin kushteve të reja të jetesës, duke u kthyer në specie ujore. Disa gjymtyrë përshtaten të kryejnë funksione të tjera, ose të rudimentohen. Në një kohë të dytë ndodhën ndryshime atmosferike në pjesë të ndryshme të globit, të cilat shtytën një pjesë të këtyre specieve ujore, të duhej të t'i përshtaten kushteve të reja (nga ato ujore në tokësore) dhe disa më pas nga kushtet tokësore në tokë e ajër sikurse bëhet fjalë me krijimin e specieve të reja nga klasa e reptilëve në atë të shpendëve.

PAK GJENEZË E YOLOGJIT: METAMORFOZA E KALIMIT TË DINOSAURËVE NË ATË TË DRAGOJVE.

Dragojtë ujinë me ndryshimin e kushteve, duke kaluar nga mjedisi ujor në ambiente tokësore, përshtatën funksionimin e gjymtyrëve kushteve të reja tokësore, duke ndryshuar anatominë në të përafërt me ata dinosaurët ujorë. Përfaqësues tipik është krokodili i sotëm, i cili mund të quhet parardhësi gjenetik i dragojve malorë.

Dragojtë, jetëgjatësia, mënyra e jetesës dhe riprodhimi, aftësitë zjarr prodhuese! Jetëgjatësia e tyre mendohet 35- 40 vjet, pesha trupore 500 deri 800 kg, gjatësia trupore 4 - 6 m. Me gjashtë gjymtyrë ekstremet e katër gjymtyrëve përfundojnë me këthetra të fuqishme. Flatrat e tyre janë me një diametër 6 m dhe lëkurorë.

Lakuriqin i natës mund të shihet si miniaturë e tij, kafshë mishngrënëse me sasira të mëdha deri në 100 kg në ditë, të cilën e kapërdin tërësisht dhe më pas e tret në orët më pas në qetësi. Kafshët të cilat mund të bien preh e tij kanë qënë, tufat e Dhive e Derrave të egër, Arinjëve, gjedhi e njëthundrakët e veçmas, tufët e mbarështuara me të imëta. Nga ky ushqim ai plotëson nevojat për mirëmbajtje e depozituar rezervë të konsiderueshme dhjamore të cilat i përdor për të përballuar energjitë e nevojshme duke e transformuar në Karbohidrate për nevojat e mirëmbajtjes si dhe prodhimin e Gazit Metan CH₄, i cili në prani dhe të mineralit platin bën të mundur ndezjen e gazit Metan. Organizmi i kësaj krijese ka në



brendësi dy dhomëza "bombla gazi" ku qëndrojnë veçmas një me hidrogjen e tjetra karbon të cilat kanë rol dhe për të mundësuar mbajtjen në ajër e fluturimin e tija edhe në distance shumë të largëta, Dragojtë janë me gjak të ftohtë dhe muajt e gjatë të dimrit i kalon në letargji, në strofull, në një gjumë të gjatë dimëror. Dragojtë çiftëzohen e riprodhojnë në moshën shtatë vjet, mbas çiftëzimit, femra pjell dy vezë me peshë me madhësi (rreth 5-6 kilogram secila), vezë këto që vendoseshin në mjedise të sigurt shpellash malore. Vendi ku inkubohen vezët rrethohet me gurë të mëdhenj të cilët nxehen me flakën që prodhijnë dragojtë që mbajnë temperaturën prej 60 gradë të nevojshme për gjithë kohën deri në çeljen, daljen e këtyre krijesave. Më pas vazhdon trajtimi dhe kujdesi për të ushqyerit e mbrojtjen e të vegjëlve të tyre, të cilat së shpejti do shtojnë e ripërtërinë ata.

Koha e rritjes zgjat tre vjet deri sa dragoi i ri të fuqizohet që të jetë në gjendje të fluturojë dhe të sigurojë ushqim për mirëmbajtje e rritje. Ky ushqim që duhet të sigurohet nga gjuetia e kafshëve në pyll apo nga tufët që mbarështonin banorët e atyre kohëve të lashta deri në mesjetë në shekullin e XV kur mendohet se është dhe zhdukur kjo specie, kafshë mish ngrënëse e tmerrshme, e cila si armë kryesore përdorte prodhimin dhe vjelljen e flakës së zjarrit që prodhonte në brendi të organizmit të saj. Këtë flake e nxirte nga goja ndaj gjahut apo armiqve të saj, duke qënë kështu kafsha më e rallë dhe e papërbalueshme e kohërave. Në gjuhën e popullit është quajtur kuçedra apo djalli i maleve ky dragua malor. Periudha e moshës së rritjes kur tek kjo kafshë nuk funksiononte mekanizmi i prodhimit dhe përdorimit të zjarrit i cili është i pa mundur para se kjo kafshë të fitojë aftësinë për fluturuar. Kjo periudhë kohore ka bërë të mundur miqësimin e kësaj kafshe të tmerrshme me njerzit, të cilët kanë guxuar të miqësohen dukë shkuar në ato shpella me rrezikshmëri të lartë dhe duke i joshur ata, duke u çuar mish, qumës, vezë e më pas pjesë kafshësh njëthundrakët të ngordhur apo aksidentuar dhe më pas ato të bashkëjetonin duke i përdorur si mjet fluturimi, ku këta njerëz kanë qënë njerëzit e parë që kanë dalë në hapësitë e duke kryer fluturime të gjata, gjuetira kafshësh dhe në mbrojtje të pronave e teritoreve të tyre me këta kuaj fluturues, "Pegasus".

Legjenda e gojdhana të cilat

qarkullojnë edhe sot në Pogradec e në rrethinat e tij

Gjatë shek të VII pas lindjes së Krishtit kryeqendra e Enkelejve, qyteti i sotëm i Pogradecit, u sulmua nga sllavët. Në këto beteja, enkelejtë kishin për krah Engjëllin mbrojtës, i cili luftonte për krah tyre i hipur në një kalë fluturues që vllite zjarr nga goja duke djegur e tmerruar ushtrinë armike për disa beteja radhas; deri sa në një betejë, vritet luftëtari, kalorësi i quajtur Kostandin. Varrimi i tij u bë me nderime të mëdha në qendër të qytetit. Mbi këtë varr u ndërtua një objekt kulti, Tyrbe, e cila shërbente për të gjithë qytetarët, pa dallim nga besimet e tyre. Ajo administrohej nga Xhamia e qytetit deri në vitin 1967, vit kur u prishën shumë kisha, xhami e objekte të tjera kulti. Edhe për shumë vite në qiellin e qytetit shfaqej shpesh ky kalë fluturues, ky dragua. Flitej se kishte vëndbanimin në malin e Kozicit, nga pjesa lindore fshatit Kalivaç. Shpella e Dragoit është edhe sot. Vëndasit e thërrasin Shpella e Guakut në Kozic. Si vëndbanim i herëshëm dragonjsh flitej edhe për shpellën e cila më pas u bë vënd strehimi i Shën Marenës, vënd pelegrinazhi edhe sot. Ky dragua malor duhet të jetë realisht simboli dhe Emblema edhe sot e qytetit, jo Dragoi paraardhës ujor, sepse nuk është ai dragoi real, ai engjëlli heroik e "Legjendari", i cili ka këtë histori bindëse ?!

Në fshatin Dunicë, mbi Sanakosë, në lartësinë sipërore të Kozicit në sinor me Qafë - Panjen, ndodhet një masiv dikur pyjor i cili quhet edhe sot Dragotinë. Sipas tregimeve gojore (R. Lazellari), kjo zonë shërbente për gjuetinë e ushqyerjen e dragojve "Pegasus"

Në Dvor, mbi fshati Trebinjë, ndodhet "Djepi i Dragoit". Sipas legjendës, ky fëmijë i lindur ndryshe nga një Zanë, e cila ditën fluturonte, shkante në malin e Kozicit. Këtë legjendë e ka dokumentuar K. Gjata shumë vite më parë, kur ka punuar arsimtar në fshatin Potgozhan. Të dhëna për këtë legjendë tregon arsimtari N. Dragoi, me origjinë vetë nga fshati Trebinjë i vëndndodhjes së këtij vëndi.

Kjo krijesë mbase është e para që mundësoi të bëhet realitet fantazia e njeriut për t'u bërë zot edhe i qiejve, mjeti i parë fluturues i njeriut. Ilirët, të parët kozmonautë!

Aludime të tjera

Zjarri i Zeusit! Gjuetia e kafshëve, dragojtë përdornin zjarrin si armë.

KOMUNIKIMI NËNTOKËSOR I BURIMEVE TË TUSHEMISHTIT DHE TË SHËN NAUMIT

Hydrogjenerimi dhe oksigjeni janë dy elementët përbërës të molekulës së ujit dhe secili prej tyre ka disa izotope të qëndrueshëm.

Pikërisht, izotopet e qëndrueshëm të tyre janë përdorur për studimin e baseneve të ndryshme ujore dhe komunikimet e tyre nëntokësore. Ndër disa studime në këtë fushë mund të përmend studimin e pellgut ujëmbajtës të Prespës dhe të burimeve të Tushemishtit e Shën Naumit.

Studimi u realizua në kuadër të një projekti me ANEA-n, me institucione kërkimore të Shqipërisë, të Greqisë dhe të Maqedonisë. Nga përcaktimi i raporteve izotopike të izotopeve të qëndrueshëm të hidrogjenit e të oksigjenit në mostrat e ujit të liqeneve të Prespës e të Ohrit dhe në burimet e Tushemishtit e të Shën Naumit dhe të studimit të dinamikës së tyre, u arrit në përfundimin se liqeni i Prespës së Madhe ka komunikim nëntokësor me burimet e Tushemishtit dhe të Shën Naumit dhe u jep burimeve të Tushemishtit rreth 53 %-54 % të sasisë tyre.

Të dhënat izotopike të studimit krijuan mundësinë për llogaritjen e bilancit hidrologjik të pellgut ujëmbledhës të liqeneve të Prespës. Është e qartë se burimet e Tushemishtit, si burime që përdoren për ujë të pijshëm, duhet të mbrohen nga ndotja dhe kjo duhet të fillojë mbrojtjen nga ndotjet e ujit të liqeneve të Prespës. Përfundimi i këtij projekti dhe rezultatet e dala prej tij u shoqëruan me organizimin e një konference shkencore në Akademinë e Shkenca në Tiranë dhe një konferencë shkencore-sensibilizuese në Pogradec.

Së fundi, nisur nga fakti që studimet kërkimore-shkencore të bazuara në izotopet e qëndrueshëm të disa elementëve të lehtë janë realizuar në bashkëpunim me kolegë të institucioneve kërkimore, mësimore e prodhuese të vendit e të huaja, u shpreh të gjithëve vlerësimin tim dhe një falenderim të thellë për punën me përkushtim e seriozitet dhe ndihmesën që ka dhënë secili në realizimin e studimeve.

Nga Prof. Dr. Jovan ZOTO

Kryeredaktor; Flori SLATINA
Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI,
Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"
Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës
Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

www.pogradeci.com/mokra

1905 - Nga Korça në Pogradec

Arëmenët e Pogradecit. – Një shëtitje me barkë në Liqenin e Ohrit. – Popullsia e Pogradecit. – Në Manastirin e Shën Naumit. – Haxhi Bira.

Nga C.N. BURILEANI

Në një mëngjes të bukur vere lashë Korçën. Sapo u nisa u përshëndeta me arumunët apo vllahët rajonalë. Me disa nga ata lëvizja me pajton drejt liqenit të Pogradecit, së bashku me Miltiadh Ballamaçi. Shoqërues kisha një përfaqësues shtetëror turk, i cili ishte shumë i kujdesuar për një udhëtim sa më të mirë për të mos pasur as dhe një shqetësim sa më të vogël të ishte.

Rruga që të çon në Liqenin e Ohrit ishte e gjatë rreth tetë orë dhe mund të them, se ishte një udhëtim i mirë. Kur mendon për kushte qenësore të rrugëve të Turqisë, duke prerë fushën ndërmjet Korçës dhe lumit të vogël Devoll, i cili kalon Maliqin. Në anën Lindore ndodhet kënetat ndërsa në Perëndim, rrëzë kodrave, vazhdon rruga që të çon në Pogradec. Gjatë këtij marshimi në afërsi të tij ndodhej një postbllok të cilën e kaluam pa asnjë vështirësi.

Para se të hynim në Pogradec pamë një situatë mjaft e bukur. Në perëndim të tij male të mrekullueshme të Mokrës, kurse në Lindje Liqeni i Ohrit. Mu duk sikur po kaloja në pararojë.

Përshtypje të tilla kënaqësie unë duhej t'i atribuoj pamjes ekskluzive (jashtëzakonshme) që më ofrohej nga një anë e shikimit pak a më shumë kontrastit rrëshqitës dhëmbor të vetmisë së maleve dhe e vendeve, që të gjitha në ato ditë të para të dukeshin mrekullira. Qetësia, kënaqësia në mënyrë të veçantë ngjyra bojë qielli e këtij liqeni me ëmbëlsinë e nderuar nga vetë natyra.

Pagabueshmëri, unë që prej dy muajsh, nuk kisha parë male të tilla, shpesh të pabanuara, lakurige nga jeshillëku, të tilla pra, që të ndërhyjnë në zemër, herëherë një trishtim i pasigurt apo i pa bazë. Nuk mundja atëherë të provoja të paktën një gëzim të thellë shënimitin e livadheve, kullotave dhe kodrave nga prospektina denjë dhe buzëqeshjeve. Vetëm kështu doja të shpjegoj gëzimin e ekzagjeruar të vizionit në shpirt të Liqenit të Ohrit.

Oh! Si ka mundësi që gjithë Shqipëria nuk do të vinte këtu në brigjet e Liqenit!



Pogradeci

Por nuk duroi shumë kjo qetësi e kënaqësi më pas, sepse duke kërkuar vetëm dy ditë e gjysmë nga arritja në Pogradec, duke mu dukur si një ëndërr e lumtur, ajo që më vuri në lëvizje përsëri në rrugë drejt komunave arumune (vllahë) të Niçës dhe Lungës (Llëngës). Do të më dilnin bezdisje, vuajtje fizike e morale. Shumë pak, pa dyshim në Europë mund të ndërmarrë një ide me plot rreziqe që mund të përballosh këtu, kur është më mirë të shkosh në Turqi, se sa në Shqipëri.

Mjaft e vështirë të shkosh për një natë në ndonjë fshat të varfër, ku mungon ushqimi për të mbajtur veten të gjallë së bashku me mundësinë për të



C.N. BURILEANI, 1905. Udhetime në pogradec, Niçë dhe Llëngë

mbyllur sytë dy orë rresht.

Ngrënia dhe fjetja! Janë dy probleme më serioze për një evropian i mësuar me një jetë komode pra të rehatshme dhe që duhet pa tjetër të mendosh se do të shkelësh dhe të përballosh vështirësi, rreziqe nëpër udhëtime me kondita të papërshtatshme e me rreziqe nga më të ndryshmet, ku nuk ka siguri. Pra do të udhëtosh në varësi të kushteve dhe situatave jo të mira. Do të ecësh diku me këmbë, diku me kalë apo mushkë për rrugëtime të gjata.

Nevoja qenësore janë që të mos mungojë ushqimi, duhet dhe pushuar jo vetëm çlodhje. Mos respektimi i këtyre të çon tek sëmundjet. Sëmundja kërkon krevat. E përsëris se fjala krevat është diçka "non sensens".

Ju lutem pastaj tek enigma në çështje shtëpiake të tilla të ngjashme si për mjek, ilaçe etj.

Shëtitje në Liqenin e Ohrit

Në ditën e parë të arritjes sime në Pogradec bëra një shëtitje me barkë në Liqenin e Ohrit në shoqërinë e kajmekanit të Pogradecit një turk nga Anadolli, gjykatësi, dy shqiptarë të myslimanizuar. Mbas kësaj shëtitje kthehem dhe



Karvaxhinjtë armënë të Pindit në rrugët e Korçës

shkoj në drejtim të hotelit së bashku me shoqëruesin tim Balamaçe për të kaluar natën. Një dhomë ku u strehuam që kishte katër mure, dy stola mbi një dyshe me prej dërrase mbi trarë druri. Hoteli duhet të ketë qenë që në kohët e vjetra por e pastër pra kishte pastërti.

Haxhi Bira pronari i këtij hoteli nuk kishte gjë për të na ofruar përveç kafesë. U shtrimë duke u mbuluar me mbulesat tona me shpresë që të mbyllim sytë të paktën e jo gjumë, pra të bënim një pushim. Gjumë ripërsëritej sapo na kish marrë unë dhe shoku im i udhëtimit më tepër kemi qëndruar në këmbë duke lëvizur e shtrënguar sikur ishim në një pozicion gjuetie, na dridheshin qimet e kokës. Kur e kujtoj më duket si një ngjarje e jashtëzakonshme. Të nesërmen sipas planit që kishim bërë për një ekskursion mbi liqen, shoqëruar nga një bej mysliman shkua për të vizituar Manastirin e Shën Naumit, i cili ishte shumë i bukur për pozicionin e tij ku është ndërtuar dhe për madhësinë që kishte. Ky manastir u la t'i përkiste arumunëve apo vllahëve. Një shkrim i vjetër provon qartësisht se të shumtat e restaurimeve ishin bërë me shpenzimet e arumunëve të Korçës dhe saktësisht nga familja Balamaçe.

Pak kohë para vizitës sime në Shën Naum, një prift kishte vizituar e qëndruar në Manastir në shoqërinë e një bande. Nuk e di se për çfarë arsye e kishin marrë me vete anglezin në mal, pra e kishin marrë peng nga ana e bandës bullgare. Tre muaj më pas dolën llafe se anglezi ishte zhdukur e keqtrajtuar dhe asgjë më tepër nuk u fol dhe nuk u dëgjua më për të.

Më vonë mora vesh nga një miku im në Romë, që kish qenë në Manastirin e Shën Naumit se i shkreti njeri që se kishin lënë të lirë. Atij i ishte prerë veshi. Dhe këtë e kishin bërë banditët. Ata kishin dërguar me poste veshin e prerë dhe kërkonin familjes që të dërgonin paratë pra të paguanin gjobën për lëshimin e anglezit në xhirot e atyre kohëve.

Popullsia e Pogradecit

Komuna e Pogradecit që shqip do të thotë *Nënkala*. Kështu është quajtur një kështjellë e vjetër që ishte gjetur më lart në mal pra aty afër. Dallohet akoma e kësaj dite. Popullsia e Pogradecit numëron 310 shtëpi, nga të cilat 190 kanë qenë të krishtere pra janë myslimanizuar, 90 i përkasin shqiptarëve të krishterë, 30 të tjerë i përkasin arumunëve apo vllahëve. Ndërmjet myslimanëve disa kultivojnë ndjenja kombëtare. Ndërsa shqiptarët të krishterë

pa përjashtim anojnë nga helenët, një pjesë e tyre kanë qenë dhe në Rumani dhe njohin mirë gjuhën rumune. Prej tyre e flasin mirë dhe është e pamundur t'i dallosh nga autentikët, këto shkruajnë mirë gjuhën vllahë. Edhe gratë e kanë përvetësuar më mirë se burrat dhe e flasin mirë atë.

Gjuhën arumune apo vllave flitet mirë në një varg rrethesh e komunash apo fshatra që bëjnë pjesë ndërmjet maleve Tomor dhe maleve Galicitza e Morava. Një fenomen i tillë ka rrënjët e thella në motivet historike. Fakti në çdo mënyrë që rrethet të përmendura¹⁾ siç duket kanë qenë në të kaluarën disa ndër foletë apo qendrat më të rëndësishme të romanizimit siç do t'i shohim më vonë dhe që në gjuhën e shqiptarëve takohen jo pak fjalë të përbashkëta shqiptare dhe arumune apo vllahë.

Arumunët e Pogradecit rrjedhin nga dy komuna Lunga (Llenga) dhe Nica por dhe nga Belica e sipërme dhe e poshtme në veri të Liqenit të Ohrit. Të tre kanë të njëjtin dialekt vllah apo arumun. Edhe fshati Remenjë ka qenë i banuar nga vllahët. Sot në të banojnë 15 familje vllahë. Fiset më të përmendura janë Gusho, Kresta e tjera.

Në përgjithësi tregtarët, pronarët, komnat e Pogradecit janë në krye të lëvizjes civile qytetare. Llogaria dhe korrespondenca është mbajtur prej tyre me karakteristikat greke, pavarësisht se nuk e flasin mirë greqishten. Me shqiptarët arumunët jetojnë në harmoni njëri me tjetrin.

Arumunët kanë tendencë në kauzat heleniste sepse kanë arsye të përbashkëta shoqërore. Ata janë të një feje të krishtere ortodokse. Klerikët e tyre kanë mbaruar shkollat ortodokse. Ata janë kompletuar me kulturë helene.

Do të thoja se në të kaluarën në Shqipëri kanë ekzistuar shkolla ortodokse në gjuhën greke. Më vonë u hapën dhe shkolla arumune. Në gjuhën arumune ka dhënë mësim Konstandini në fshatin Remenjë. I biri i tij me emrin Gjoku njihej në Pogradec për punë tregtie.

Haxhi Bira

Ka qenë arkimandrit në Manastirin e Shën Marenës së Llëngës. Ishte arumun me origjinë nga Samarina, bashkëshort i një arumuneje të komunës së Llëngës, ka tani dy fëmijë të rritur me të ka qenë këshilltar komune në Pogradec. Pesëmbëdhjetë vjet me radhë ka qenë drejtor i emëruar i shkollës vllahë në Elbasan në Shën Maronë të Llëngaj. Ai drejtonte një numër shkollash arumune, fal lavdisë së tij lëshon një autorizim për të hapur shkolla të tilla në Vllaharani, Pretori, Damasi, Keaticeani etj.

Haxhi Bira ishte anëtar i delegacionit arumun apo vllah në Konferencën e Fuqive të Mëdha për të drejtat e arumunëve.

Si këshilltar i komunës së Pogradecit Haxhi Bira punoi me përkushtim për kryerjen me përpikëri, respektonte autoritet lokal dhe respektohej nga ata. Ka një korrespondencë të gjerë me arumunët e Bitohas apo Manastirit. Ai falë Zotit na priti mirë dhe na mbajti për tri ditë me radhë gjatë qëndrimit tonë në Pogradec.

(vijon në numrat e ardhshëm)

Përktheu: Llazi Tona

Marrë nga libri "Arëmenët e Shqipërisë", redaktuar nga Akademiku Prof. Dr. Antonio Baldaci